



Koordinationsstelle Häusliche Gewalt
Post da coordinaziun violenza a chasa
Servizio di coordinamento violenza domestica

**DHUNA NUK ËSHTË
GJË PRIVATE.
THYEJE MURIN
E HESHTJES.**



**Një e treta e veprave
penale kryhet brenda
familjes ose partneritetit.**

Guxo të marrësh ndihmë.

Ti nuk je vetëm.

www.gr.ch/haeusliche-gewalt





Koordinationsstelle Häusliche Gewalt
Post da coordinaziun violenza a chasa
Servizio di coordinamento violenza domestica

Dhuna në familje do të thotë, që persona brenda familjes, brenda një partneriteti aktual ose të mëparshëm ushtrojnë dhunë ose kërcënojnë me ushtrimin e dhunës.

Dhunë ka forma të ndryshme, si për shembull:

Dhuna fizike: goditje, shtytje, shkundje, kafshime ose mbajtje me forcë

Dhuna psikike: sharje, kanosje, ofendime ose frikësime

Dhuna seksuale: të detyrosh një person tjetër për veprime seksuale

Dhuna ekonomike: heqja e parave ose ndalimi i ushtrimit të punës

Dhuna sociale: të burgosësh një person tjetër ose ta ndalosh atë të takohet me familjen ose me shokët

Dhuna në familje nuk tolerohet dhe është e dënueshme.

Ku mund të gesh ndihmë?

Policia

Ndihmë në rast emergjence,
numri telefonik **117**.

Fëmijë dhe adoleshentë

Ndihmë në çdo kohë në numrin **147**
(telefoni, WhatsApp ose e-mail).
Më shumë informata: www.147.ch.

Ndihmë për viktimë

Këshillimi për persona të prekur nga dhuna dhe të afërmit të tyre. Falas dhe konfidencial.
Më shumë informata: www.soa.gr.ch ose në numrin telefonik **081 257 31 50**, i arritshëm për 24 orë në ditë për këshillime të shkurtra në numrin telefonik **081 25 77 142** (që nga nëntori 2025).

Shtëpia e grave

Mbrojtje për gra dhe fëmijët e tyre. Më shumë informata: www.frauenhaus-graubuenden.ch ose në numrin telefonik **081 252 38 02**.

Orar konsultimi “Forensic Nursing”

Ekzaminimi mjekësor dhe dokumentimi i plagosjeve. Falas dhe konfidencial. Informata dhe terminë: www.ksgr.ch/forensic-nursing ose në numrin telefonik **079 923 11 44**.

Këshillimi për persona që ushtrojnë dhunë

Falas dhe konfidencial. Më shumë informata: www.gewaltberatungsstelle.gr.ch ose në numrin telefonik **079 544 38 63**.

Dëshmitare dhe dëshmitarë

Në rast rreziku thirrni menjëherë policinë (**117**).
Informata dhe këshillime nën www.gr.ch/haeusliche-gewalt.

Numra të rëndësishëm telefonikë

Policia: 117 (24 orë)

Ambulanca: 144 (24 orë)

Fëmijë dhe adoleshentë
147 (24 orë)

Ndihmë për viktimë Graubünden
081 257 31 50
081 25 77 142 (24 orë që nga nëntori 2025)

Shtëpia e grave Graubünden

081 252 38 02 (24 orë)

Orar konsultimi “Forensic Nursing”

079 923 11 44
forensicnursing@ksgr.ch

Oferta të tjera ndihme për fëmijë, adoleshentë, gra, burra, prindër, persona të moshuar, mjedisin shoqëror dhe persona të specializuar nën www.gr.ch/haeusliche-gewalt